



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:075450

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06361410

KPPP.nr. 927/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me numër të biznesit 70280741 dhe seli në Prishtinë, kundër debitorit Tur – Kos Farm Sh.P.K., me numër të biznesit 71055086 dhe seli në Vushtrri, rr. “Krujes”, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 223/15, i lejuar me datë 05.05.2015, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Tur – Kos Farm Sh.P.K., me numër të biznesit 71055086 dhe seli nw Vushtrri, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 223/15, i lejuar me datë 05.05.2015, nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 140508049067/292, e datës 04.03.2015, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 223/15, të datës 05.05.2015, me të cilin është urdhëruar debitori Tur Kos Farm Sh.P.K., që ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumë prej EUR 608.08, me kamatë ligjore 8%, duke filluar nga data 15.04.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se propozimi për përmbartim ka të meta sa i përket të dhënave lidhur me adresën/selinë e debitorit, duke shënuar F.K. si pronar të vetëm, mirëpo i njëjti është vetëm njëri nga themeluesit e jo pronari i vetëm. Më tej, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është

lejuar urdhri përbarimor nuk është e rregullt. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se debitori ka shfrytëzuar numrin 37745999013 për periudhën e caktuar dhe është krijuar borxhi në vlerë prej 608.08 €. Ndërsa, sa i përket pretendimeve për të dhënat e debitorit, të dhënat e shkruara me dorë nga Përmbartuesi Privat janë shënuar me qëllim të sigurimit të të dhënave shtesë për debitorin. Ka shtuar se propozimi për përbarim i përmban të gjitha elementet sipas nenit 38 të LPP-së, ndërsa debitori në prapësimin e tij nuk ka ofruar prova me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij sipas nenit 69, par. 4 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në faturë nuk janë përshkruar shërbimet e ofruara debitorit dhe në të njëjtën nuk është përcaktuar saktë shuma e cila është detyrim për periudhën kohore për të cilën është lëshuar fatura, 01.02.2015 deri 28.02.2015, për arsye se në faturë është përcaktuar borxhi paraprak në lartësi prej EUR 540.04, mirëpo nuk është treguar se si ka rrjedhur ky borxh i debitorit, për cilat shërbime apo për cilën periudhë kohore.

Përveç të metave si më lartë, gjykata gjen se fatura nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe e njëjta nuk rezulton të jetë pranuar nga debitori. Ndërsa, në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshmohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt, dhe si e tillë, fatura mbi bazën e së cilës eshët lejuar urdhri paraqet dokument të njëanshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë andaj edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 927/24, datë 28.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.